

RREGULLORE PER CERTIFIKIMIN E SISITEMIT TE MENAXHIMIT TE ENERGIJE

GJENDJA E DOKUMENTIT					
RR-C-008					
	06.02.2021	07	Perditesime ne afatet e tranzicionit sipas udhezuesit te DPA		
	15.06.2020	06	Perditesime nga gjendja e pandemise globale COVIT 19, ne baze te njoftimeve te IAF		
	08.05.2019	05	Perditesime nga ndryshime ne formatin e dokumentacionit te AQSCERT (Logo)		
	10.09.2018	04	Perditesime nga ndryshimi i standartit		
	04.04.2017	03	Nderlidhje e rregullores me rregulloren e pergjithshme		
	05.09.2016	02	Riklasifikimi i tipeve te NC (ne tipi A-B-C)		
	05.09.2015	01	Ndryshime ne formatin e logos		
	03.01.2013	00	HARTIMI I PARE		
KODI I DOK.	DATA	RISH.	PERSHKRIMI IRISHIKIMIT	HARTOI	APROVOI

PJESA 1: CERTIFIKIMI I SISTEMEVE TË MENAXHIMIT TË ENERGJISË SIPAS ISO 50001: 2018
PJESA 2: CERTIFIKIMI I SISTEMEVE TË MENAXHIMIT TË ENERGJISË SIPAS ISO 50001: 2011
PJESA 3: KALIMI I CERTIFIKIMIT NGA ISO 50001: 2011 NË ISO 50001: 2018

PJESA 1: CERTIFIKIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË ENERGJISË NË PËRPUTHJE ME ISO 50001: 2018

KREU 1 – TË PERGJITHSHME

1.1 Kjo rregullore përcakton procedurat plotësuese dhe / ose zëvendësuese, të përdorura nga AQSCERT për certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit të Energjisë në lidhje me ato që janë përcaktuar tashmë në Rregulloren e Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit.

Pikat e kësaj rregulloreje i referohen (dhe mbajnë numrin e njëjtë) në pikat përkatëse të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit për të cilat janë bërë modifikime dhe / ose shtesa.

1.2 AQSCERT lëshon çertifikimin sipas kërkesave të ISO / IEC 17021: 2015 për Kompanite, Sistemi i Menaxhimit të të cilave është njohur në përputhje me të gjitha kërkesat e standardit ISO 50001:2018.

KAPITULLI 2- STANDARDET E REFERENCES / KERKESAT E CERTIFIKIMIT

2.1 Përveç asaj që përcaktohet në Rregulloren e Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, për të marrë çertifikimin nga AQSCERT, një SME fillimisht duhet të përmbushë kërkesat e standardit ISO 50001 dhe ato shtesë, kur parashikohet, nga Organet e Akreditimit

2.2 Në zëvendësim të dispozitave të paragrafit 2.2 të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, për të marrë çertifikimin e Sistemit të Menaxhimit të Energjisë, kompania duhet:

• TË KETE REALIZUAR ANALIZEN E KONTEKSTIT:

- ✓ Te jap prova se vet kompania ka realizuar dhe kuptuar analizen e kontekstit
- ✓ Te demonstrojë njohuri dhe kuptim të nevojave dhe pritshmerive të palëve të interesuara

• TË KETE PËRCAKTUAR PLANET E VEPRIMIT PËR TË ADRESUAR RISQET DHE MUNDËSITË

• TË KETE PËRCAKTUAR NJË PLAN PËR TË MBLEDHUR TË DHENAT ENERGJITIKE

• TË KETE REALIZUAR NJE RISHIKIM TË ENERGJISË, QË PËRFSHIN:

- ✓ Konsumin e energjisë dhe faktorët e energjisë në të shkuarën dhe të tashmen në bazë të matjeve dhe të dhënave të tjera;
- ✓ Identifikimin e zonave të konsumit të konsiderueshme të energjisë, në mënyrë të veçantë për ndryshimet e rëndësishme në përdorimin e energjisë gjatë periudhës së mëparshme;
- ✓ një vlerësim të konsumit të energjisë për periudhën në vazhdim;
- ✓ identifikimin e të gjithë personave që punojnë për kompaninë, ose në emër të kompanisë, veprimet e të cilëve mund të çojnë në ndryshime të rëndësishme në konsumin e energjisë;
- ✓ përcaktimin e performancës aktuale energjetike të strukturave, pajisjeve, sistemeve dhe proceseve lidhur me identifikimin e përdorimeve të konsiderueshme të energjisë;
- ✓ Identifikimin dhe përcaktimin e një shkalle prioritetesh në lidhje me mundësitë për të përmirësuar efikasitetin e energjisë.

• TË KETE INFORMACIONIT TË DOKUMENTUAR QË PËRFSHIN:

- ✓ qellimin dhe kufijtë e SME
- ✓ metodologjinë për përcaktimin e analizës së energjisë dhe vlerësimin e rëndësisë së përdorimit të energjisë;
- ✓ skenarin e referencës së performancës energjetike të kompanisë;
- ✓ indikatorët e performancës së energjisë;
- ✓ planet e veprimit për përmirësimin e performancës së energjisë;
- ✓ planin e monitorimi të të dhënave të rëndësishme të energjisë;
- ✓ elementet kryesore të sistemit dhe ndërveprimet e tyre;
- ✓ përshkrimin e kompanisë

• TË KETE IMPLEMENTUAR DHE MIREMBAJTUR SME NË PËRPUTHJE ME KERKESAT E STANDARDIT ISO 50001: 2018

SME konsiderohet plotësisht e implementuar nëse:

- është aplikuar prej të paktën tre muaj;
- sistemi i auditimit të brendshëm është plotësisht i implementuar dhe efektiviteti i tij mund të demonstrohet;

- është kryer dhe dokumentuar të paktën një rishikim i sistemit të menaxhimit;
- janë vlerësuar dhe identifikuar përdorimet e konsiderueshme të energjisë;
- janë krijuar dhe dokumentuar objektivat, targetet dhe programet e lidhura me menaxhimin e energjisë;
- procedurat dhe praktikët që kontribuojnë për të parandaluar situatat që mund të çojnë në devijime nga politika energjetike, targetet dhe objektivat e energjisë janë përcaktuar, zbatuar dhe mirëmbajtur;
- janë përshkruar dhe dokumentuar kërkesat për monitorimin, matjen dhe identifikimin e qëllimeve të programit të menaxhimit të energjisë;
- është përcaktuar dhe implementuar një plan i llogaritjes së energjisë;
- është demonstruar një përmirësimi në performancën e energjisë, siç përcaktohet në pikën 9, të standardit ISO 50001:2018 "Vlerësimi i performancës".

KAPITULLI 3 – CERTIFIKIMI FILLESTAR

3.1 Kompania duhet t'i sigurojë AQSCERT, duke plotësuar të gjitha rubrika e formularit specifik "Kërkesa për oferte FO-C-001" i disponueshëm në www.AQSCERT.org, informacione specifike për Standardin ISO 50001

- qëllimi i kërkuar për certifikim;
- çdo aktivitet / sit, impjant apo pjesë perberese e tyre, e përjashtuar nga qëllimi i SME, në mënyrë që të verifikohet pranueshmëria e përjashtimeve të tilla, duke ditur që standardi ndërkombëtar ISO 50003 konsideron mundësinë që të përfshijë të gjithë kufijtë e kompanisë (të gjitha sitet në rastin e një kompanie multi-sit) ose pjesë të saj për sa kohë që transportuesit e energjisë nuk përjashtohen nga kufijtë e përcaktuar;
- konsumi i përgjithshëm vjetor i energjisë [TJ], për çdo sit të kompanisë;
- numrin dhe përshkrimin e transportuesve të energjisë në përdorim, për secilin sit të kompanisë;
- numri i përdoruesve të konsiderueshme të energjisë për secilin sit të kompanisë;
- numri i të punësuarve të SME, i ndarë sipas funksioneve, për secilin sit të kompanisë.

3.4 Përveç asaj që përcaktohet në Rregulloren e Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit pika 2.4, së bashku me kërkesën për certifikim ose pas kërkesës për certifikim, kompania duhet të vërë në dispozicion të AQSCERT dokumentet e mëposhtme:

- dokumenti "Kërkesa për oferte FO-C-001" VETEM PËR CERTIFIKIMIN ISO 50001, të plotësuar në të gjitha pjesët e tij, duke bashkangjitur çdo dokument të nevojshëm;
- listën e legjislacionit/autorizimeve / regjistrave të BE-së të zbatueshme nga kompania.

AQSCERT shqyrton dokumentet e mësipërme për konformitetin me standardin e referencës dhe me kërkesat e këtyre rregulloreve.

3.5 Ashtu sikurse edhe thuhet në pikën 2.5 të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, gjatë auditimit në fazën 1, do të kontrollohet korrektësia e informacionit të dhënë nga kompania përmes një pyetësi informues. Në rast të ndryshimeve midis të dhënave të siguruar fillimisht nga kompania në pyetësin informues dhe të dhënave homologe të verifikuara gjatë auditimit në fazën 1 nga grupi i auditimit, kohëzgjatja totale e auditimit do të rishikohet dhe modifikohet përfundimisht.

Në rast se kohëzgjatja e auditimit, që vjen nga rishikimi i ri, është më shumë se kohëzgjatja e përcaktuar më parë, komunikimi specifik klientit do t'i jepet me e-mail duke siguruar kohëzgjatjen e duhur dhe të re të auditimit.

Nëse kompania nuk dëshiron të pranojë kohëzgjatjen e re, atëherë kompania duhet të paguajë AQSCERT për auditimin e fazës 1 siç është rënë dakord më parë, të sigurojë një justifikim të përshtatshëm brenda 10 ditëve pune nga komunikimi i marrë dhe të pranojë ndërprerjen e procesit të certifikimit.

Në mungesë të përgjigjes nga kompania për komunikimin specifik, pranohet në mënyrë të heshtur termi i ri, bazuar në të dhënat e verifikuara nga ekipi i auditimit, të paraqitura në mënyrë transparente dhe të diskutuara gjatë mbledhjes së fazës 1 të auditimit.

KAPITULLI 4 – MIREMBAJTJA E CERTIFIKIMIT

4.2 Përveç asaj që përcaktohet në Rregulloren e Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit pika 3.1, kompania duhet të mbajë informacione të dokumentuara në lidhje me:

- rishikimin e energjisë së përdorur, mundësisht duke përfshirë paraqitjen e lokacionit (eve) dhe diagramin e rrjedhës së energjisë (transportuesit e energjisë);
- organigramën e kompanisë;
- lista e procedurave të brendshme të rëndësishme për SME;
- lista e kërkesave ligjore të detyrueshme dhe kërkesave të tjera vullnetare të nënshkruara nga kompania;

- kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit / QKR, ose dokument ekuivalent
- lista e siteve të përkohshme me përshkrimin e aktivitetit të kryer;

të gjitha informacionet e mëparshme të dokumentuara duhet të jenë në dispozicion të AQSCERT së bashku me veprimet korrigjuese të kryera gjatë auditimeve periodike.

Kompania duhet ta mbajë AQSCERT të informuar për çdo vërejtje/raportim të autoriteteve kombëtare ose lokale në lidhje me fushën e energjisë dhe për çdo situatë të mospërputhjes legislative në lidhje me të gjitha aktivitetet e kompanise, pavarësisht nga fusha e zbatimit të sistemit të menaxhimit.

KAPITULLI 5 – REALIZIMI I AUDITIMEVE

5.1 TE PERGJITHSHME

5.1.1 Përveç dispozitave të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit pika 5.1, moskonformitetet nënkupton gjithashtu një situatë që zvogëlon kapacitetin e sistemit të menaxhimit për të siguruar kontrollin e përdorimeve të konsiderueshme të energjisë dhe / ose përputhjen me kërkesat e detyrueshme legislative. Moskonformitetet e medha (klasifikohen si gjetjet e tipit A), moskonformitetet e vogla (klasifikohen si gjetjet e tipit B) dhe rekomandimet për përmirësim (klasifikohen si gjetjet e tipit C).

5.2 AUDITIM I CERTIFIKIMIT FILLESTAR

Auditimi fillestar i certifikimit përfshin dy faza (faza 1 dhe faza 2)

5.2.1 – Faza 1

Në zëvendësim të dispozitave të paragrafit 5.2.1. të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, auditimi i fazës 1 i kryer në kompani, ka si qëllim te:

- verifikoj që dokumentacioni i sistemit të menaxhimit të energjisë, duke përfshirë procedurat, plotëson të gjitha kërkesat e standardit;
- vlerësoj nëse auditimet e brendshme dhe rishikimi i menaxhimentit janë planifikuar dhe kryer në të gjitha sitet që kompania kërkon të certifikohet;
- rishikoj gjendjen e të kuptuarit të klientit për kërkesat e standardit, veçanërisht në lidhje me identifikimin e performancës kryesore ose aspekteve sinjifikative, proceset, objektivat dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të energjisë;
- mbledh informacionin e nevojshëm në lidhje me fushën e sistemit të menaxhimit, proceset dhe vendndodhjen (et) e klientit, duke përfshirë aspektet perkatese ligjore dhe rregullatore dhe pajtueshmërinë me to;
- verifikoj që kompania ka të gjitha autorizimet / licencat e nevojshme në lidhje me menaxhimin e energjise dhe aktivitetet e saj, dhe të verifikoj që ato janë të vlefshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- kryej një inspektim të sitit të Prodhimit të kompanise për të vlerësuar çdo çështje kritike që nuk konsiderohet nga Sistemi i Menaxhimit të Energjisë së kompanise;
- rishikoj shpërndarjen e burimeve për auditimin në fazën 2 dhe të bjere dakort me klientin mbi detajet e auditit të fazës 2;
- përqëndrohet në planifikimin e auditit në fazën 2, përvetësimin e njohurive të mjaftueshme për sistemin e menaxhimit dhe aktivitetet në sitet e klientit, duke iu referuar aspekteve të mundshme sinjifikative;
- verifikoni që SGE ka qene në funksionim prej të paktën tre muaj dhe se procedurat janë zbatuar në mënyrë efektive.

Rezultati i auditimit të fazës 1 i jepet kompanise duke lëshuar kopjen e raportit të auditimit të fazës 1, mbi të cilin, përveç të tjerash, raportohet për gjetjet e evidentuara, përfshirë ato që mund të klasifikohen si jokonformitete (të mëdha ose të vogla) gjatë auditimit të fazës 2.

Veprimet e ndërmarra nga kompania për zgjidhjen e këtyre gjetjeve verifikohen gjatë auditimit të fazës 2 të përmendur në pikën 5.2.2.

Gjetjet që konsiderohen të jenë veçanërisht kritike, sipas mendimit të grupit të auditit që kanë kryer auditimin në fazën 1, duhet të zgjidhen para se të vazhdohet me auditimin e fazës 2 në kompani; në rast të auditimeve të njepasnjeshme të fazës 1 dhe fazës 2, auditimi i fazës 2 duhet të rishikohet dhe shtyhet për një datë tjetër (jo më larg se 6 muaj nga data e auditimit të fazës 1).

5.2.2 – Faza 2

Në zëvendësim të dispozitave të pikës përkatëse 5.2.2 të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, auditimi i fazës 2 në kompani duhet të bëhet brenda një periudhe maksimale prej 6 muajsh nga përfundimi i auditimit të fazës 1.

Auditimi në fazën 2 në kompani kryhet për të verifikuar zbatimin korrekt dhe efektiv të sistemit të menaxhimit.

AQSCERT i dërgon kompanise, përpara se të kryhet auditimi i fazën 2 në sit (et), një plan auditimi që detajon përshkrimin e aktiviteteve dhe dispozitave për kryerjen e auditimit.

Nëse aktivitetet që duhet të verifikohen kryhen në disa site operative, auditimi kryhet sipas kritereve të përcaktuara më parë dhe i komunikohet nga AQSCERT kompanise.

Auditimi i fazës 2 kryhet nga grupi I auditit AQSCERT në bazë të raportit të auditimit të fazës 1 dhe dokumenteve të Sistemit të Menaxhimit të Energjisë, të përgatitur nga kompania në rishikimin e azhurnuar.

Auditimi I fazes 2 konsiston ne:

- një takim fillestar me teknikët e kompanise për të rënë dakord mbi qëllimet dhe metodat e auditimit për të konfirmuar dispozitat e planit të auditimit;
- një verifikim të implementimit të veprimeve efektive të adaptuara në lidhje me vlerësimet që dolën gjatë auditimit të fazës 1;
- një inspektim i sitit (eve) të Prodhimit të kompanise, me intervista për të gjitha funksionet e përfshira, veçanërisht ato që lidhen me përdorime të konsiderueshme të energjisë, për të verifikuar përputhjen e sistemit të menaxhimit të energjisë, me dokumentet referuese dhe ekzekutimin e tij të plotë;
- një takim i fundit për të ilustruar rezultatin e auditimit.

Me perfundimin e auditit faza 2, kompanise i dorezohet nje raport audit (FO-C-008). Në prani të moskonformiteteve të mëdha (gjetjet e tipit A), procesi i certifikimit pezullohet; në rastin e moskonformiteteve të vogla numri i të cilit, sipas mendimit të grupit të auditimit, është i tillë që të paragjykojë funksionimin korrekt të Sistemit të Menaxhimit, procesi i certifikimit pezullohet gjithashtu.

Në raste të tilla, brenda gjashtë muajve, AQSCERT duhet të kryejë një auditim shtesë që ka për qëllim verifikimin e efektivitetit të trajtimeve dhe të veprimeve korrigjuese të propozuara; pas përfundimit të suksesshëm të këtij auditimi, procesi i certifikimit do të rifilloj.

Auditimi shtesë mund të kryhet në vend ose në baza dokumentare bazuar në llojin e veprimeve korrigjuese që duhet të verifikohen sipas mendimit të ekipit të auditimit.

Të gjitha shpenzimet në lidhje me çdo auditim shtesë që rezultojnë nga mangësitë në Sistemin e Menaxhimit janë në ngarkim të kompanise kliente.

Nëse afati i lartpërmendur është tejkaluar, Sistemi i Menaxhimit të Organizatës duhet të jetë subjekt i një auditimi brenda një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh nga data e përfundimit të fazës 2 të auditimit, duke përdorur kriteret (metodat dhe kohën e auditimit) të parashikuara për një auditim të fazës 2.

Pasi që periudha e mësipërme dymbëdhjetë mujore të kalojë pa përfundim pozitiv të vlerësimit, AQSCERT mund të konsiderojë të mbyllur procedurën e certifikimit, duke ngarkuar kohën dhe shpenzimet e bëra deri në atë kohë.

Në raste të tilla kompania që dëshiron të vazhdojë me certifikimin duhet të paraqesë një kërkesë të re dhe të përsërisë procesin e certifikimit.

Kufijtë e lartpërmendur mund të ndryshohen në raste të veçanta me kërkesë të arsyetuar nga kompania, dhe të gjykuar nga AQSCERT.

KAPITULLI 6 – MENAXHIMI I CERTIFIKATAVE TE KONFORMITETIT

6.1 Certifikatat e lëshuara në përputhje me ISO 50001: 2011 do të skadojnë më 19 gusht 2021, data që përkon me përfundimin e periudhës së tranzicionit.

KAPITULLI 8 – KARAKTERISTIKA SPECIFIKE PËR KOMPANITE MULTI-SITE

8.1 Përveç dispozitave të pikës përkatëse 8.1 të Rregullores të Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, një kompani, jo domosdoshmërisht një person i vetëm juridik (vetëm emri i kompanisë), që vepron në disa site të përhershme dhe kërkon një certifikim të vetëm, për t'u konsideruar multisite dhe për të qenë në gjendje të zbatohet logjika e kampionimit, duhet të përmbushen kushtet e mëposhtme, si për sitet, ashtu edhe për zyren qendrore:

- të gjitha sitet kanë një lidhje ligjore ose kontraktuale me zyren qendror të kompanise;
- të gjitha sitet janë subjekt i një sistemi të vetëm menaxhimi, i cili përcaktohet, themelohet dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe auditimeve të brendshme nga zyra qendrore;
- është identifikuar një zyre qendrore, që është pjesë e kompanise dhe nuk është nënkontraktuar nga një kompani e jashtme/pale e trete (për shembull një kompani konsulence); është përgjegjës për të siguruar që të dhënat janë mbledhur dhe analizuar nga të gjitha sitet; është në gjendje të demonstrojë autoritetin dhe aftësinë e tij për të filluar ndryshimet organizative; është në gjendje të menaxhojë dokumentacionin e sistemit dhe ndryshimet; është në gjendje të kryejë rishikimet e sistemit të menaxhimit; është në gjendje të trajtojë ankesa për të gjithë kompanine; është në gjendje të vlerësojë veprimet korrigjuese; ka autoritetin të kërkojë që sitet të zbatojnë veprime korrigjuese kur është e nevojshme në çdo sit; është në gjendje të planifikojë ciklet e auditimit të brendshëm dhe të vlerësojë rezultatet e tyre; është në gjendje të menaxhojë kërkesat ligjore dhe rregullatore në lidhje me sistemin e menaxhimit; ka autoritetin organizativ të përcaktojë, krijojë dhe mirëmbajë sistemin e vetëm të menaxhimit;
- proceset që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e përdorimeve sinjifikative dhe konsumit të energjisë janë kryesisht homolog në të gjitha sitet ose organizohen duke përdorur metoda të ngjashme;
- zyra qendrore garanton si kërkesë energjetike:

- ✓ proceset e planifikimit të energjisë të harmonizuara dhe koherente;
- ✓ kriteret për përcaktimin dhe korrigjimin e skenarit të referencës, variabla përkatese dhe treguesve të harmonizuar dhe koherent të performancës së energjisë (SME);
- ✓ kriteret të harmonizuara dhe koherente për përcaktimin e objektivave, synimeve dhe planeve të veprimit;
- ✓ procese të centralizuara për të vlerësuar zbatueshmërinë dhe efektivitetin e planeve të veprimit dhe Indikatorëve të Performances Energjitike
- ✓ të dhënat e performancës së energjisë së grumbulluar në mënyrë qendrore për të treguar nivelin e përgjithshëm të performances energjitike të kompanisë.

PJESA 3: TRANZICIONI I CERTIFIKIMIT NGA ISO 50001:2011 NE ISO 50001:2018

A.0 – TE PERGJITHSHME

AZHORNIM: SI PASOJE E PANDEMISE COVID-19 AFATET E TRANZICIONIT TE STANDARDIT ISO 50001:2018 JANE SHTYRE ME 6 MUAJ DERI NE 19 SHKURT 2022

Ky seksion përdoret kur një kompani, qe zoteron nje certifikim sipas standardit ISO 50001: 2011, kërkon kalimin e certifikimit sipas versionit te azhurnuar te standardit ISO 50001: 2018, në vijim referuar si tranzicion. Për të siguruar certifikimin e AQSCERT sipas versionit te rishikuar të standardit, Sistemi i Menaxhimit të Energjisë fillimisht duhet të plotësojë kërkesat e standardit ISO 50001: 2018 dhe ato shtesë të kërkuara nga Organet e Akreditimit.

Kompania duhet të tregojë se ka implementuar dhe përdorur në mënyrë korrekte elementet e ndryshimit duke përfshirë:

- te demonstroj se ka marrë parasysh kontekstin e vet në përcaktimin e qellimit te sistemit dhe në planifikimin e sistemit të menaxhimit bazuar në risqet dhe mundësitë e tij;
- te demonstroj që i kuptojnë nevojat dhe pritshmerite e palëve të përfshira;
- te demonstroj se ka përcaktuar veprimet për të adresuar risqet dhe mundësitë;
- te demonstroj se grumbullimi i të dhënave të energjisë është planifikuar;
- te demonstroj se ka përcaktuar dhe zbatuar kriteret për vlerësimin e performancës së energjisë (efikasiteti i energjisë, përdorimi i energjisë dhe konsumi i energjisë);
- te demonstroj përmirësim të vazhdueshëm.

A.1 – APLIKIMI I TRANZICIONIT

Gjatë periudhës së tranzicionit, kompania e certifikuar tashmë me ISO 50001: 2011, mund të zgjedhë të bëjë kalimin në standardin e ri:

1. gjate një auditimi mirembajtje (me një shtese të mundshme të kohës së auditimit);
2. gjate nje auditim ricertifikimi;
3. midis dy auditimeve të planifikuara.

Kërkesa për të bërë kalimin duhet t'i dërgohet AQSCERT nga një përfaqësues i autorizuar i kompanisë klient. Pas kërkesës së tranzicionit, AQSCERT i dërgon kompanisë "Kërkesa për oferte" FO-C-001 që duhet të plotësohet në të gjitha pjesët e tij për Certifikimin sipas ISO 50001:2018, duke bashkëngjitur dokumentacionin kur është e nevojshme. Bazuar në informacionin e raportuar në kete formular, AQSCERT përcakton nëse është e mundur të vazhdohet me kalimin e standardit dhe, në rast të një shtese në kohën e auditimit, përgatit një ofertë të përshtatshme ekonomike të kufizuar në auditimin e tranzicionit. Koha minimum shtesë e auditimit është 0.5 dite/njeri për të vlerësuar në mënyrë efektive ndryshimet dhe efektivitetin e zbatimit.

A.2 – PERFORMANCA E AUDITIMIT TE TRANZICIONIT/KALIMIT

Auditimi i tranzicionit konsiston në:

- nje rishikim i dokumentuar i elementeve te ndryshuar bazuar ne "Kerkesa per oferte FO-C-001" dhe ne informacionin e dokumentuar te kerkuar nga ISO 50001:2018;
- nje auditim on-site per te verifikuar zbatimin e kerkesave te reja ne perputhshmeri me ISO 50001:2018. Per proceduren e realizimit te auditimit shiko dispozitat e Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e sistemeve të menaxhimit pika 5. Nese gjate periudhës së tranzicionit, konstatohen jokonformitete kryesore në krahasim me ISO 50001: 2018, dhe nese keto jokonformitete nuk zgjidhet sipas kushteve të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme për certifikimin e Sistemeve të Menaxhimi, jokonformitete te tilla nuk do të ndikojnë negativisht në mirëmbajtjen e certifikimit në periudha e vlefshmërisë, me kusht që natyrisht të konstatohet se sistemi i menaxhimit të energjisë vazhdon të ruaj pajtueshmërinë me ISO 50001: 2011. Perioditeti dhe shtrirja e kontroleve vijuese për mirëmbajtjen e certifikimit mbeten te pandryshuar dhe ndjekin dispozitat e programit tre vjeçar të auditimit.

A.3 – LËSHIMI I CERTIFIKATËS SË KONFORMITETIT SIPAS ISO 50001: 2018

Kur auditimi i tranzicionit ka përfunduar me një rezultat të favorshëm, sipas një auditimi paraprak të realizuar nga AQSCERT, lëshohet një Certifikatë Konformiteti për edicionin e ri të standardit, vlefshmëria e të cilit do të llogaritet bazuar në datën e vendimit të mëparshëm për certifikim / ricertifikim.

A.4 – VLEFSHMËRIA E CERTIFIKATAVE NË PËRPUTHJE ME ISO 50001: 2011

Certifikatat e lehuara sipas ISO 50001: 2011 do të skadojnë më 19 shkurt 2022.

Kompania e cila, pas datës së skadimit të certifikatës, nuk ka përfunduar ende me sukses tranzicionin dhe synon të hyjë përsëri në certifikim, duhet të paraqesë një aplikim të ri sipas procedurës për certifikimin fillestar; nëse kërkesa paraqitet brenda një viti nga data e skadimit të certifikatës së vjetër, jo më vonë se 19 shkurt 2022, ulja maksimale e aplikueshme mund të përdoret kur përcaktohet kohëzgjatja e certifikimit fillestar.